- (⁴) Date of loading. Imports of these animals shall not be allowed when the animals were loaded either prior to the date of authorization for exportation to Albania of the third country, territory or part thereof referred to in boxes reference I.7 and I.8., or during a period where restrictive measures have been adopted by the Albania against imports of these animals from this third country, territory or part thereof.
Data e ngarkimit. Importimi i këtyre kafshëve nuk lejohet kur kafshet ngarkohen ose para datës së autorizimit për eksportim në Shqipëri nga vendet e treta, territoret ose zonat e tyre të referuara në kutitë I.7 dhe I.8, ose gjatë një periudhe kur masat kufizuese janë përshtatur nga Shqipëria kundër importit të këtyre kafshëve nga ky vend i treta, territor ose zone e tij.
- (⁵) Surveillance programme as laid down in Annex I to Commission Regulation (EC) No 1266/2007 (OJ L283, 27.10.2007, p. 37.).
Programi i mbikëqyrjes siç përcaktohet në Shtojcën I të Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 1266/2007 (OJ L283, 27.10.2007, f. 37.).

Official veterinarian
Veterineri zyrtar

Name (in Capital letters):
Emri (me germa kapitale)

Date:
Data
Stamp
Vula

Qualification and title:
Kualifikimi dhe titulli

Signature:
Firma :

VENDIM
Nr. 17, datë 30.3.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Elsa Toska	anëtare e Gjykatës Kushtetuese, Kryesuese e seancës
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “

me sekretare Enina Kotoni, në datat 25.2.2021
dhe 30.3.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare
mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 41 (S) 2017 të
Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SUZANA SHOTA

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Besnik
Mustafaj, Erjon Sejdiaj, Agjencia Shtetërore e
Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2017-
1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ
të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit deri në
përfundimin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata
Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1,
shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 71 e
vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Marsida
Xhaferllari, shqyrtoi pretendimet e kërkuësës, e cila
kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit
të interesuar, Besnik Mustafaj, i cili kërkoj rrëzimin
e kërkesës, parashtrimet e Agjencisë Shtetërore të



Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë, të cilat kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Suzana Shota dhe shoqëria “Konstruksion F.B.” sh.p.k., me ortak dhe administrator subjektin e interesuar, Besnik Mustafaj, kanë qenë palë kundërshtare në një proces gjyqësor civil për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë, të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, pas shqyrtimit gjyqësor, ka dhënë vendimin nr. 2888, datë 12.10.1999 për rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 186, datë 15.2.2001, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 460, datë 23.4.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për pranimin e padisë. Në përfundim të këtij procesi gjyqësor është vendosur detyrimi i shoqërisë “Konstruksion F.B.” sh.p.k. të pushojë cenimin e pronësisë ndaj banesës së kërkueses, duke paguar shumën 75,648 USD (\$) për dëmin e shkaktuar.

2. Ndërkohë, menjëherë pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, kërkuesja ka filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për vendimin gjyqësor që përmbante detyrimin monetar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 359, datë 19.4.2001, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Zyra e Përmbaramit Kavajë ka regjistruar çështjen në ekzekutim dhe e ka numërtuar, duke i nxjerrë të gjitha aktet sipas numrit themeltar 248 dhe fraksionit të tij 248/B. Kjo zyrë, me tri vendime të datës 1.6.2001, ka vendosur masën e sekuestros për katër pasuri të paluajtshme (tri apartamente dhe një lokal), të ndodhura në fshatin Kryemedhenj, Golem, të regjistruara në pronësi të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj. Në datën 18.6.2001 është vendosur nga përmbaruesi gjyqësor nxjerrja në ankand e katër pasurive dhe në datën 2.7.2001 fitues të ankandit kanë rezultuar kërkuesja Suzana Shota dhe bashkëshorti i saj. Me vendimin e datës 24.8.2001, Zyra e Përmbaramit Kavajë ka vendosur kalimin e katër pasurive në pronësi të kërkueses dhe bashkëshortit të saj, si dhe ka urdhëruar

ZVRPP-në, Kavajë për të kryer regjistrimin.

3. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, pas sekuestrimit të katër pasurive, por përpara zhvillimit të ankandit, konkretisht në datën 6.6.2001, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë për kundërshtimin e veprimeve përmbare, duke kërkuar përjashtimin e pasurive të paluajtshme nga sekuestrimi dhe shitja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 276, datë 13.7.2001, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin, ndër të tjera, se subjekti i interesuar, pas dhënies së vendimit gjyqësor që përmbante detyrim monetar për t’u ekzekutuar prej shoqërisë “Konstruksion F.B.” sh.p.k., kishte kryer veprime juridike për tjetërsimin e kuotave të shoqërisë të vëllai i tij në mashtrim të ligjit për t’u shmangur detyrimit, dhe rrjedhimisht, këto veprime janë nul. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 430, datë 30.7.2001, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 733, datë 8.7.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Në datën 30.6.2002 bashkëshortja e subjektit të interesuar, Shpresa Mustafaj, me pretendimin se katër pasuritë ishin fituar gjatë martesës, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë me objekt përjashtimin nga sekuestroja dhe shitja e pasurive nga Zyra e Përmbaramit Kavajë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 230, datë 5.7.2002, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 523, datë 30.10.2002. Këto vendime janë ndryshuar nga Gjykata e Lartë, e cila, me vendimin nr. 337, datë 12.2.2004, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykatat kanë zbatuar keq ligjin, pasi paditë për veçimin e pjesës së bashkëpronarit dhe padia e kërkimit të sendit ngrihen vetëm gjatë fazës së ekzekutimit, fazë e cila në rastin konkret ishte kapërcyer.

5. Në vijim, subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, i është drejtuar sërish gjykatës për të kundërshtuar veprimet përmbare për zhvillimin e shitjes në ankand të pasurive dhe për kundërshtimin e vendimit të datës 24.8.2001 të Zyrës së Përmbaramit Kavajë për kalimin në pronësi të apartamenteve në emër të kërkueses. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 390, datë 5.11.2002, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se ajo është parashkruar për



shkak të ngritjes së saj jashtë afatit ligjor. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 182, datë 4.3.2003 dhe në vijim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr.1010, datë 13.5.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

6. Me kërkesë të ZVRPP-së, Kavajë për rikonfirmim të dokumentacionit për shkak të korrigjimit në numrin e pasurive, Zyra e Përmbartimit Kavajë, me vendimin e datës 4.6.2003, ka bërë korrigjimin e vendimit të saj të datës 24.8.2001 dhe ka kërkuar mbajtjen e pasurive në sekuestro për shkak të procesit gjyqësor që po zhvillohej për to. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, e ka kundërshtuar gjyqësisht këtë vendim të përmbartuesit, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 552, datë 28.12.2004, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se të drejtat e subjektit të interesuar mbi sendin dhe fatin e tij në qarkullimin civil janë shuar për shkak se sendi ka kaluar në pronësi të kreditorit. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 325, datë 20.6.2005, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

7. Ndërkohë që çështja ishte në proces gjyqësor, Zyra e Përmbartimit Kavajë, me vendimin e datës 23.2.2004, ka vendosur refuzimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit nr. 359, datë 19.4.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se veprimet përmbartimore nuk janë kryer ndaj pasurive të shoqërisë debitoare “Konstruksion F.B.” sh.p.k., por ndaj pasurive të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj. Dy ditë më vonë, me vendimin e datës 25.2.2004, kjo zyrë ka vendosur heqjen e sekuestros për pasuritë e paluajtshme dhe në vijim, në datën 27.2.2004 ZVRPP-ja, Kavajë ka lëshuar kartelat e pasurisë me shënimet përkatëse në emër të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

8. Pas këtyre veprimeve, kërkuësja dhe bashkëshorti i saj kanë kundërshtuar gjyqësisht dy vendimet e përmbartuesit të datave 23.2.2004 dhe 25.2.2004 për refuzimin e ekzekutimit dhe heqjen e sekuestros ndaj pasurive në fjalë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 451, datë 22.10.2004, ka vendosur pranimin e padisë për kërkimin që lidhej me refuzimin e ekzekutimit, ndërsa ka rrëzuar padinë për pjesën që lidhej me heqjen e masës së sekuestros. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 170, datë 4.4.2005, ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi, duke e

rrëzuar padinë, me arsyetimin se ajo ishte ngritur jashtë afatit ligjor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1620, datë 25.2.2005, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësës dhe bashkëshortit të saj.

9. Nga ana tjetër, ZVRPP-ja, Kavajë në datën 21.6.2004 ka bërë kalimin e katër pasurive në pronësi të kërkuësës Suzana Shota dhe bashkëshortit të saj, bazuar në vendimin e datës 24.8.2001 të Zyrës së Përmbartimit Kavajë të nxjerrë nga rezultati i ankandit, duke vlerësuar se ky vendim ishte ende në fuqi.

10. Në të njëjtën datë, më 21.6.2004, kërkuësja dhe bashkëshorti i saj kanë shitur 2 prej pasurive të shtetasi M.L., për të cilin ZVRPP-ja, Kavajë ka lëshuar edhe certifikatat respektive të vërtetimit të pronësisë. Për të njëjtat pasuri kishte lidhur kontrata shitjeje edhe subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, me shtetasin B.K.

11. Në këtë situatë, blerësi prej kërkuësës, shtetasi M.L., së bashku me kërkuësen dhe bashkëshortin e saj i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për rivendikimin e dy pasurive ndaj subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, dhe blerësit prej tij, shtetasit B.K. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 600, datë 9.10.2006, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shtetasit B.K. t'i dorëzojë shtetasit M.L. pasuritë përkatëse. Në përmbajtje të këtij vendimi gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: *“gjykata i referohet vendimeve të sipërvituar”, duke nënkuptuar vendimet nr. 390, datë 15.11.2002 dhe nr. 230, datë 5.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë sipas formës përfundimtare të tyre: “si vendime të formës së prerë, me të cilat është ezauruar pretendimi i të paditurit Besnik Mustafaj se sekuestrimi dhe shitja nuk duhej bërë mbi pronat e tij, por mbi ato të shoqërisë ...” dhe “... veprimet juridike për kalimin e pronësisë të kryera nga i padituri Besnik Mustafaj me të paditurit B.K jo vetëm kanë qenë në keqbesim, për të shmangur detyrimet ndaj paditëseve Mark Shota e Suzana Shota, por duke mos u regjistruar kontratat e shitjes në ZVRPP-në Kavajë, ato janë të pavlefshme sipas nenit 83 të Kodit Civil.”.* Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 510, datë 12.11.2007, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2079, datë 9.12.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit.

12. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, i është drejtuar sërish ZVRPP-së, Kavajë me kërkesë për



fshirjen e regjistrimit të pasurisë në emër të kërkuës dhe të subjektit tjetër të interesuar, Erjon Sejdiaj, në zbatim të vendimit të datës 23.2.2004 të Zyrës së Përbarimit të Rrethit Gjyqësor Kavajë, me të cilin ishte vendosur refuzimi i ekzekutimit dhe heqja e sekuestros (*shih paragrafin 7 të këtij vendimi*). ZVRPP-ja, Kavajë, me vendimin nr. 4, datë 4.5.2010, i është drejtuar kryeregjistruesit, duke kërkuar që regjistrimet në emrin e kërkuës të mos fshihen, me arsyetimin se titulli është ekzekutuar tërësisht dhe se vendimi i kalimit të pasurive në pronësi të kërkuës dhe bashkëshortit të saj nuk është kundërshtuar në rrugë gjyqësore. Kryeregjistruesi, me vendimin nr. 151, datë 12.6.2010, ka vendosur pushimin e procedimit administrativ në zbatim të vendimit nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin pas kontrollit kushtetues të disa dispozitave ligjore që lidheshin me regjistrimin e pasurive të paluajtshme, ZQRPP-së i ishte hequr juridiksioni për të trajtuar ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive.

13. Në këto kushte, subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka kundërshtuar gjyqësisht dy vendimet e mësipërme të regjistruesit dhe të kryeregjistruesit, duke kërkuar regjistrimin e katër pasurive në favorin e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9631, datë 15.12.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të mosparaqitjes pa arsye të këtij subjekti të interesuar si palë paditëse. Çështja është kthyer për rigjykim, me tjetër trup gjykues, nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 123, datë 5.4.2011.

14. Pas rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10824, datë 12.11.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar dy aktet administrative dhe duke urdhëruar ZVRPP-në të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistër në favor të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj. Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se veprimet e kryera nga zyra e përbarimit janë absolutisht të pavlefshme, pasi janë kryer jo mbi pasuritë e debitorit, shoqëria “Konstruksion F.B.” sh.p.k., por mbi pasuritë personale të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

15. Mbi apelet e kërkuës dhe të ZQRPP-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4237, datë 19.11.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10824, datë 12.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e

kërkesëpadisë. Në përmbajtjen e vendimit, kjo gjykatë ka arsyetuar, ndër të tjera, se refuzimi i urdhrit të ekzekutimit nuk mund të bëhet nga përbaruesi kur titulli është ekzekutuar tërësisht dhe se pretendimet për kundërshtimin e veprimeve përbarimore, të cilat janë zgjidhur me vendime gjyqësore të formës së prerë, nuk mund të gjykohen sërish.

16. Mbi rekursin e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se e drejta e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, për të kërkuar fshirjen buron nga e drejta e tij e pronësisë për katër pasuritë e paluajtshme, të cilat kanë kaluar në kundërshtim të hapur me ligjin në favor të kreditorëve të shoqërisë “Konstruksion F.B.” sh.p.k. dhe për këtë shkak të gjitha veprimet përbarimore janë absolutisht të pavlefshme.

17. Kërkesja në datën 25.9.2017 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në datën 30.1.2018, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila prej datës 8.2.2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjes konkrete. Me plotësimin e kuorumit, kjo çështje iu nënshtrua bisedimeve nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

18. Ndërkohë që çështja ishte në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese, me kërkesën e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10788 akti, datë 17.11.2017, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, sipas ndryshimeve të vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vijim të të cilit është bërë edhe regjistrimi i pronave në favor të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

19. Në datën 11.5.2018, kërkesja Suzana Shota dhe bashkëshorti i saj kanë paraqitur sërish kërkesëpadi në gjykatë për kundërshtimin e



veprimeve përmbartimore në bazë të urdhrit të ekzekutimit të mësipërm. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (82-2018-1277) 832, datë 26.12.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se veprimet përmbartimore janë kryer në përputhje me ligjin dhe se nuk cenon asnjë të drejtë të palës paditëse, që siç është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk janë bërë asnjëherë pronarë të pasurive. Ky arsyetim është bazuar në vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet në këtë gjykim kushtetues. Kërkesja dhe bashkëshorti i saj kanë paraqitur apel dhe çështja është regjistruar në datën 8.11.2019 në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ende nuk ka dhënë vendim. Për rrjedhojë, ky proces gjyqësor midis palëve nuk është mbyllur me një vendim përfundimtar.

20. Në datën 7.2.2019 është miratuar ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me të cilin kompetencat e ZQRPP-së dhe ZVRPP-së, Kavajë i kanë kaluar respektivisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore Kavajë. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që është ushtruar kompetenca administrative e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

21. Drejtoria Vendore Kavajë në datën 29.1.2021 ka njoftuar me shkrim se tri prej pasurive janë regjistruar në emër të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, ndërsa pronësia e pasurisë së katërt ka kaluar me kontratë shitblerjeje të dy shtetas të tjerë. Nga kopjet e kartelave të pasurisë konstatohet se këto veprime janë kryer pas dhënies së vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

22. **Kërkesja**, në kërkesën drejtuar Gjykatës, pretendon se vendimi gjyqësor i kundërshtuar është dhënë në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se janë cenuar:

22.1 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ka cenuar, për pasojë, edhe

të drejtën e pronësisë. Gjithashtu, siguria juridike është cenuar, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur në konsideratë se e drejta e pronësisë së kërkuar për pasuritë e paluajtshme ka marrë fuqinë e gjësë së gjykuar me procese gjyqësore përfundimtare të mëparshme, që kanë vlerësuar të ligjshme veprimet përmbartimore.

22.2 *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencën ligjore për të vlerësuar pranueshmërinë e rekursit dhe ka vendosur nëpërmjet Kolegjit Administrativ në dhomë këshillimi për themelin e mosmarrëveshjes, duke marrë një kompetencë që ligji ia jep Gjykatës së Lartë vetëm në seancë gjyqësore.

22.3 *E drejta e njoftimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka shpallur ditën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues për shqyrtimin e rekursit në çështjen gjyqësore, të përfunduar me vendimin e kundërshtuar nga kërkuarja.

23. **Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj**, ka paraqitur prapësimet me shkrim, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, si të pambështetur në Kushtetutë dhe në fakte, me argumentet e përmbledhura si vijon:

23.1 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike, që është thelbi i mosmarrëveshjes së rastit konkret, pasi sekuestroja ishte vendosur mbi pasurinë e një personi tjetër dhe jo të debitorit, dhe për këtë shkak shitja në ankand dhe regjistrimi i këtyre pasurive në favor të kërkuarës ishin veprime absolutisht të pavlefshme.

23.2 E drejta e pronës së kërkuarës nuk është cenuar nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ajo nuk e ka fituar asnjëherë atë në mënyrë të rregullt dhe, për rrjedhojë, kërkuarja nuk legjitimohet në ngritjen e kërkesës së saj. Nëse Gjykata Kushtetuese urdhëron rigjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, rigjyrimi nuk ka asnjë efekt, pasi kërkuarja nuk e ka fituar ndonjëherë të drejtën e pronësisë dhe pavlefshmëria absolute e veprimeve nuk mund të riparohet.

23.3 *Parimi i sigurisë juridike* nuk është cenuar, pasi vendimi nr. 17, datë 23.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, ndonëse nuk ka sqaruar llojin e efekteve të tij, ka efekte *ex nunc* dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet mosrespektimi i tij në



rastin konkret, ku veprimet për fshirjen dhe regjistrimin e pasurive janë kryer për korrigjimin e veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Pranimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese do të cenonte sigurinë juridike për të drejtat e të tretëve që janë sot pronarë të pasurive të paluajtshme. Gjë e gjykuar në mosmarrëveshjen konkrete nuk përbën e drejta e pronësisë së kërkuar për pasuritë, por e drejta e subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, për të kërkuar fshirjen e kësaj të drejte.

23.4 Veprimet përmbauesit të gabuara ndaj subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, dhe shoqërisë “Konstruktion F.B.” sh.p.k. kanë shkelur nenin 11 të Kushtetutës, pasi kërkuarja deri më sot nuk ka paguar një pjesë të çmimit të blerjes së sendit në ankand. Për rrjedhojë, regjistrimi i pronave në datën 26.6.2004, në favor të saj ka qenë i gabuar.

23.5 Pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj bazohet në mendimin e pakicës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar keq ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 dhe ndryshimet ligjore procedurale lidhur me rolin e ri të Gjykatës së Lartë.

23.6 Pretendimi për shkeljen e rregullave të njoftimit nga Gjykata e Lartë nuk është i vërtetë.

24. **Subjekti i interesuar, Erjon Sejdiu**, ndonëse u njoftua rregullisht për zhvillimin e seancave, nuk paraqiti shpjegime me shkrim.

25. **Subjekti i interesuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës**, ka paraqitur shpjegime me shkrim, duke parashtruar se pretendimet e kërkuar janë të bazuara, pasi në mënyrë të përmbledhur janë cenuar:

25.1 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka ngarkuar ZVRPP-në, Kavajë me kompetenca për të fshirë regjistrimet e pasurive të paluajtshme, duke mos respektuar vendimin nr.17, datë 23.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

25.2 *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka në kompetencë me ligj për të disponuar në dhomë këshillimi me vendim për themelin e mosmarrëveshjes.

26. **Subjekti i interesuar, Drejtoria Vendore Kavajë**, ka paraqitur shpjegime me shkrim, duke parashtruar se i qëndron pozicionit që ky subjekt ka mbajtur në proceset gjyqësore pranë gjykatave të

juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit pretendimet e kërkuar janë të bazuara.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

27. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka parashtruar se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vlerësuar pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike, që është thelbi i mosmarrëveshjes midis palëve në këtë gjykim kushtetues.

28. Gjykata vëren se bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P”, ka në juridiksionin e saj gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se Gjykata Kushtetuese, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta, e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimin nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 31.7.2017; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata, duke marrë në konsideratë se kërkuarja ka kërkuar respektimin e zbatimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, vlerësimi i së cilës është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, çmon se pretendimi i subjektit të interesuar është i pabazuar.

B. Për pezullimin e vendimit gjyqësor

30. Kërkuarja, në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës, në datën 25.9.2017, ka kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë deri sa vendimi i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. Sipas saj, nga zbatimi i këtij vendimi mund të vijnë pasoja të pariparueshme që cenojnë të drejtën e pronësisë.

31. Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 20.1.2021, pasi mori në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga



kërkuesja për pezullimin e zbatimit të vendimit, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 8577/2000, vlerësoi se në rastin konkret pasojat që vijnë nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohen të pariparueshme për të drejtën e pronësisë që pretendon kërkuesja. Për më tepër, duke analizuar kohën e gjatë që ka kaluar nga dhënia e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë deri në datën e shqyrtimit të kërkesës për pezullim nga Mbledhja e Gjyqtarëve, në raport me faktin se kërkuesja nuk ka paraqitur më kërkesë ose dokumente shtesë për të argumentuar pasojat negative nga zbatimi i vendimit të kundërshtuar, atëherë këto pasoja nuk mund të konsiderohen se janë reale ndaj interesave të kërkueses, në kuptim të urgjencës që legjitimon caktimin e masës së përkohshme të pezullimit. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pezullimin e vendimit.

C. Për legjitimitimin e kërkesës

32. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

33. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

34. Gjykata vlerëson se kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi që kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuesja nuk legjitimohet për shkak se ajo nuk e ka fituar rregullisht të drejtën e pronësisë, është i pabazuar. Ajo paraqitet në këtë

gjykim kushtetues, para së gjithash, si bartëse e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi, sipas pretendimeve të saj, i kanë cenuar të drejtën kushtetuese të pronës.

35. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike*, vendimi nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuesja, është përfundimtar. Për rrjedhojë, në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, ajo ka përmbushur edhe këtë kusht paraprak, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës.

36. Gjithashtu, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ është i datës 7.6.2017, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është depozituar në datën 25.9.2017, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

37. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesja në thelb të kërkesës së saj pretendon se vendimi gjyqësor i kundërshtuar është rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor, në drejtim të parimit të sigurisë juridike (në aspektet e mosrespektimit të fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të parimit të gjësë së gjykuar), të gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe të së drejtës së njoftimit. Këto pretendime do të analizohen në vijim nga Gjykata.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

38. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, duke e parashtruar këtë pretendim në dy aspekte të veçanta. Më konkretisht, ajo pretendon se nuk është respektuar fuqia detyruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe fuqia e gjësë së gjykuar.

C.1.1 Për mosrespektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese

39. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar vendimin nr. 17, datë 23.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar kompetencat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme për fshirjen e regjistrimeve.

40. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ndonëse nuk ka sqaruar llojin e efekteve të tij, ka



efekte *ex nunc*, dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pretendohet mosrespektimi i tij në rastin konkret, ku veprimet për fshirjen dhe regjistrimin e pasurive janë kryer për korrigjimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

41. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehën qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021, nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në çështjen konkrete, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shfuqizimin e akteve administrative të ZQRP-së dhe të ZVRPP-së, Kavajë, të nxjerra në vitin 2010, duke urdhëruar ZVRPP-në të fshijë regjistrimin e katër pasurive që figuronin në emër të kërkuess Suzana Shota dhe të subjektit të interesuar Erjon Sejdiaj dhe, në vijim, t'i regjistrojë në emër të subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj.

Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i mësipërm është dhënë nga Gjykata e Lartë pas vendimit nr. 43. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin u shfuqizua neni 10, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë, i ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, si i papajtuesshëm me Kushtetutën, duke i hequr zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme juridiksionin për të trajtuar ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive. Nga ana tjetër, në arsyetimin e vendimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shpreh: "Bëhet fjalë për një regjistrim dhe kërkesë për çregjistrim jo mbi bazën e meritave të pasjes ose jo të titullit të pronësisë, e cila do të bënte që veprimi të ishte ushtrim i një atributi gjyqësor për të cilën është shprehur Gjykata Kushtetuese, duke shfuqizuar nenin në fjalë, por bëhet fjalë për çregjistrimin e një vendimi i cili

është pasojë e një gabimi që është bërë nga vetë përmbarimi, i cili pas njohjes me faktet ka revokuar urdhrin e tij dhe në këto kushte, administrata e ZRPP-së dhe Kryeregjistruese, thjesht duhet të pasqyrojë në regjister ndryshimet që nënkuptonte një gjë të tillë."

44. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë të gjitha proceset gjyqësore të zhvilluara midis palëve, vëren se është e qartë që nuk bëhet fjalë për procedurë korrigjimi gabimesh prej zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pasi vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka shqyrtuar dhe vlerësuar titujt e pronësisë së palëve, duke vendosur se e drejta e pronësisë i takon subjektit të interesuar dhe për këtë shkak zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të procedojë me çregjistrimin e pasurive në emër të kërkuessve dhe, në vijim, me regjistrimin e tyre në favor të subjektit të interesuar. Për pasojë, pretendimi i subjektit të interesuar se vendimi nr. 17, datë 23.4.2010, nuk zbatohet në çështjen konkrete është i pabazuar, sepse në kohën e dhënies së vendimit nga Gjykata Kushtetuese, procesi gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve ishte ende në zhvillim e sipër, pra i papërfunduar.

45. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar fuqinë detyruese të vendimit nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë pretendimi i kërkuess për cenimin e parimit të sigurisë juridike në këtë aspekt është i bazuar.

Ç.1.2 Për mosrespektimin e gjësë së gjykuar

46. Kërkuessa ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk ka mbajtur në konsideratë fuqinë e gjësë së gjykuar me vendimin nr. 276, datë 13.7.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

47. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se pranimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese do të cenonte sigurinë juridike për të drejtat e të tretëve që janë sot pronarë të pasurive të paluajtshme, që janë objekti material i mosmarrëveshjes së palëve.

48. Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar gjënë e gjykuar si pjesë të sigurisë juridike dhe të lidhur me procesin e rregullt. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në



rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 50, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka pohuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruuese arsyetuese të vendimit, me kusht që ato të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkesja Suzana Shota dhe subjekti i interesuar Besnik Mustafaj, përveç procesit gjyqësor të përfunduar me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që është objekt kundërshtimi në këtë gjykim, janë përfshirë edhe në shtatë procese të tjera gjyqësore, për shkak të mosmarrëveshjeve për katër pasuri të paluajtshme, që kanë lindur nga procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor nr. 186, datë 12.10.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin shoqëria “Konstruksion F.B.” sh.p.k. detyrohej të përmbushte detyrimin në të holla ndaj kërkuess Suzana Shota për shkak të cenimit të së drejtës së saj të pronësisë.

51. Katër prej këtyre proceseve gjyqësore janë përfunduar me vendime, të cilat kanë rrëzuar pretendimet e palëve për shkaqe procedurale që lidheshin me afatet e ngritjes së padive ose shuarjen e së drejtës materiale të palëve (*shih paragrafët 4–6 dhe 8 të këtij vendimi*), që nënkupton se vendimet gjyqësore respektive, ndonëse janë bërë përfundimtare në pikëpamje të procedurës së shqyrtimit të ankimeve deri në gjykatat më të larta, ato nuk kanë fuqinë e gjësë së gjykuar për të drejtat e pronësisë të pretenduara nga palët, pasi gjykata nuk ka vlerësuar themelin e mosmarrëveshjes.

52. Një proces tjetër gjyqësor, i vënë në lëvizje nga kërkesja dhe bashkëshorti i saj, me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore të kryera për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, sipas ndryshimeve me vendimin nr. 00-2017-1423 (704),

datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është ende në zhvillim e sipër në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këtë gjykim, i cili ende nuk ka përfunduar, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (82-2018-1277) 832, datë 26.12.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin, ndër të tjera, se kërkesja dhe bashkëshorti i saj, siç është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk janë bërë asnjëherë pronarë të pasurive. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni gjykata e shkallës së parë i është referuar gjykimit të përfunduar me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet në këtë gjykim kushtetues (*shih paragrafin 19 të këtij vendimi*).

53. Situata paraqitet e ndryshme te dy proceset e tjera gjyqësore. Konkretisht, në procesin gjyqësor të vitit 2001, të vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, është vlerësuar me vendim gjyqësor përfundimtar se veprimet përmbartimore për nxjerrjen në ankand dhe shitjen e katër pasurive të paluajtshme, me qëllim plotësimin e detyrimit në të holla, ishin të ligjshme (*shih paragrafin 3 të këtij vendimi*). Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi është përcaktuar, ndër të tjera, se subjekti i interesuar, pas dhënies së vendimit gjyqësor që përmbante detyrim në të holla për t'u ekzekutuar prej shoqërisë “Konstruksion F.B.” sh.p.k., kishte kryer veprime juridike për tjetërsimin e kuotave të shoqërisë të vëllai i tij në mashtrim të ligjit, për t'u shmangur detyrimit dhe, rrjedhimisht, këto veprime janë nul.

54. Po ashtu, në procesin gjyqësor të vitit 2006, të vënë në lëvizje prej kërkuess, është vlerësuar me vendim gjyqësor përfundimtar e drejta e pronësisë për dy prej pasurive të paluajtshme. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi gjykata është shprehur se pretendimi i subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj, se sekuestrimi dhe shitja nuk duhej bërë mbi pronat e tij, por mbi ato të shoqërisë, është shqyrtuar më parë me vendime gjyqësore të formës së prerë. Po ashtu, gjykata është shprehur se veprimet juridike për tjetërsimin e pasurive nga subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, te persona të tretë kanë qenë në keqbesim dhe të pavlefshme (*shih paragrafin 11 të këtij vendimi*).

55. Gjykata, paraprakisht analizës së vendimit gjyqësor të kundërshtuar, në raport me standardet kushtetuese të mësipërme, vlerëson se nuk qëndron argumenti i subjektit të interesuar, Besnik Mustafaj,



se shfuqizimi eventual i vendimit gjyqësor të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë do të cenojë sigurinë juridike për të drejtat e të tretëve që janë sot pronarë të pasurive të paluajtshme. Të drejtat e të tretëve janë të ndërrarura nga të drejtat e palëve në proces, objekt i këtij gjykimi kushtetues, por legjislacioni në fuqi ka mjete efektive në dispozicion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla, rregullimin e pasojave dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

56. Nga analiza e vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që kundërshtohet në këtë gjykim kushtetues, Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ ka arsyetuar se e drejta e paditësit për të kërkuar fshirjen buron nga e drejta e tij e pronësisë për katër pasuritë e paluajtshme, të cilat kanë kaluar në kundërshtim të hapur me ligjin në favor të kreditorëve të shoqërisë “Konstruksion F.B.” sh.p.k. dhe për këtë shkak të gjitha veprimet përmbartimore janë absolutisht të pavlefshme. Në arsyetimin e këtij vendimi konstatohet se nuk janë parashtruar si fakte dy proceset gjyqësore të vitit 2001 dhe vitit 2006, midis palëve ndërgjyqëse, që kanë vlerësuar dhe vendosur për të drejtën e pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe ligjshmërinë e veprimeve përmbartimore. Për më tepër, ndonëse Gjykata Administrative e Apelit ka përdorur gjënë e gjykuar si një prej argumenteve kryesore për rrëzimin e padisë dhe subjekti i interesuar në rekursin e tij e ka kundërshtuar këtë argument shprehimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe ka heshtur nëse në rastin konkret zbatohet ose jo koncepti i gjësë së gjykuar.

57. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka urdhëruar fshirjen e regjistrimit të pasurive në emër të kërkuësve, me arsyetimin se e drejta e pronësisë së tyre ishte fituar në kundërshtim me ligjin, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk ka respektuar fuqinë e gjësë së gjykuar.

Ç.2. Për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

58. Kërkuësja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin

e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për procedurën dhe llojin e vendimmarrjes në dhomë këshillimi, për shkak të ndryshimeve kushtetuese të kompetencave të Gjykatës së Lartë të vitit 2016.

59. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar, pasi bazohet në mendimin e pakicës të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, që ka interpretuar keq ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 dhe ndryshimet ligjore procedurale lidhur me rolin e ri të Gjykatës së Lartë.

60. Gjykata vëren se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 kompetencat e Gjykatës së Lartë janë reformuar, duke përfshirë tashmë në juridiksionin e saj vetëm shqyrtimin e çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit (neni 141 i Kushtetutës). Për shkak të delegimit që neni 141 ka bërë të ligji, Kuvendi ka miratuar ndryshimet ligjore të nevojshme për zbatimin e kompetencave të reja kushtetuese të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuadër është miratuar edhe ligji nr. 39/2017 (hyrë në fuqi në datën 21.4.2017), me të cilin është amenduar ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (ligji nr. 49/2012). Këto ndryshime kanë përcaktuar regjim tranzitor të ndryshëm për çështjet në proces, pasi në nenin 11 të ligjit nr. 39/2017 parashikohet: *“Çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.”* Me këtë bazë ligjore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 49/2012, përpara ndryshimeve, pasi çështja konkrete u regjistrua në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e depozituar në datën 18.12.2014.

61. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

Ç.3. Për cenimin e së drejtës të njoftimit

62. Kërkuësja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e saj të njoftimit, pasi, në shkelje të ligjit, nuk ka shpallur ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Sipas kërkuësës, në shqyrtimin e çështjes së saj ka munguar shpallja publike, pasi në



faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në rubrikën “*Lista e çështjeve administrative për gjykim, datë 7.6.2017*”, e shpallur në datën 17.5.2017, nuk është publikuar çështja objekt kundërshtimi.

63. Subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, ka prapësuar se pretendimi i kërkuësës për shkeljen e rregullave të njoftimit nuk është i vërtetë, pasi njoftimet kryhen nga Gjykata e Lartë përmes afishimit në ambientet e kësaj gjykate.

64. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata e Lartë, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimet nr. 59, datë 16.9.2016; nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Në çështjen konkrete, ashtu siç prapëson subjekti i interesuar, Besnik Mustafaj, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuësës nuk është i vërtetë. Kërkuësës i është komunikuar rekursi dhe ka marrë dijeni në datën 31.1.2015, me anë të dëftesës së komunikimit të rekursit, duke iu krijuar mundësia për të paraqitur parashtrimet e saj lidhur me shkaqet e rekursit të paraqitur nga subjekti i interesuar. Ndryshe nga sa pretendon kërkuësja, nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se në përputhje me nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, çështja është publikuar në shpalljet e datës 10.5.2017, duke njoftuar se seanca do të zhvillohej në dhomë këshillimi në datën 31.5.2017, në orën 09:15. Sipas informacionit për përfundimin e seancave të çështjeve administrative të datës 31.5.2017 ka rezultuar se është vendosur shtyrja e seancës për në datën 7.6.2017, sërish në dhomë këshillimi. Nga materialet e dosjes së Gjykatës së Lartë (procesverbali i seancës gjyqësore të datës 7.6.2017) rezulton se Kolegji Administrativ

i Gjykatës së Lartë është shprehur se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit procedural me anë të shpalljes publike.

66. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar është haptazi i pabazuar.

67. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuësës Suzana Shota lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të fuqisë së gjësë së gjykuar, është i bazuar, për rrjedhojë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2017-1423 (704), datë 7.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.3.2021.

Shpallur më 26.4.2021.

Anëtarë: Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Përparim Kalo



VENDIM
Nr. 171, datë 22.4.2021

**PËR MIRATIMIN E “KODI I ETIKËS
GJYQËSORE”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 147 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë; të nenit 83/1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Kodi të Etikës Gjyqësore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Naureda Llagami

KODI I ETIKËS GJYQËSORE

Duke marrë parasysh standardet e njohura ndërkombëtarisht mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat në mënyrë të veçantë i garantojnë secilit barazinë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj;

Duke respektuar Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara;

Duke iu referuar Rekomandimit CM/Rec (2010)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për gjyqtarët, në lidhje me pavarësinë, evidencën dhe përgjegjësitë; duke u mbështetur te Rekomandimet e Kievit të OSBE-së për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Juglindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore (2010) dhe duke i adaptuar objektivat, të cilët ato shprehin;

Duke marrë parasysh Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve dhe Memorandumin

Shpjegues të saj të përgatitur nga Këshilli i Evropës;

Duke marrë parasysh Parimet e Bangalore për Sjelljen Gjyqësor, miratuar nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor (2002), *Magna Carta*-n e Gjyqtarëve të miratuar nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (2010), Kartën e Gjyqtarëve në Evropë, miratuar nga Shoqata e Gjyqtarëve Evropianë (1997) dhe Kodin Global të Etikës Gjyqësore të Bolonjës dhe Milanos, miratuar në Konferencën Ndërkombëtare për Pavarësinë Gjyqësore (2015);

Duke pranuar se një gjyqësor i pavarur, efektiv dhe i paanshëm është i domosdoshëm për të dhënë drejtësi në një shoqëri demokratike, për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të garantuar liritë individuale të çdo individi dhe akses të barabartë në gjykatë;

Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë që dispozitat që synojnë të sigurojnë garanci më të mira për kompetencat, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve të plotësohen me një kod të etikës gjyqësore,

Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes së gjyqtarëve, si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Standardet e etikës gjyqësore dhe rregullat e sjelljes të gjyqtarit, në vijim “Kodi i Etikës Gjyqësore”, janë tërësia e parimeve, normave dhe rregullave, të cilat udhëheqin sjelljen e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe veprimtarisë së tij jashtëgjyqësore.

2. Kodi i Etikës Gjyqësore synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe ligjin.

3. Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t’i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Dispozitat e këtij Kodi duhet të interpretohen dhe zbatohen për të arritur këtë objektiv.

4. Kodi i Etikës Gjyqësore zbatohet nga të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Pjesë të këtij Kodi, të cilat kanë të bëjnë me jetën private, kanë natyrë këshillimore dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe nga gjyqtarët e komanduar në pozicione të tjera.



5. Rregullat e këtij kodi zbatohen për aq sa është e mundur edhe për nëpunësit civilë gjyqësorë në gjykata, për këshilltarët ligjorë, si dhe ndihmësit ligjorë. Të gjitha subjektet ndaj të cilëve zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë kod, duhet të marrin masa që të rregullojnë menjëherë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e tyre në pajtim me rregullat e këtij Kodi.

II. PARIMET BAZË TË KODIT TË ETIKËS GJYQËSORE

A. Parimi i pavarësisë

6. Gjyqtari përgjigjet vetëm përpara ligjit. Ai i përmbush detyrat e tij i lirë nga çdo ndikim i jashtëm dhe është i pavarur nga pushtetet e tjera, nga grupet e interesit dhe nga palët gjatë gjykimit të një çështjeje. Gjyqtari nuk është i detyruar t'i sqarojë qëndrimet e tij ligjore dhe gjendjen e vërtetuar të fakteve, përveçse kur arsyeton vendimin gjyqësor ose kur kjo i kërkohet për shkak të ligjit. Sipas këtij parimi gjyqtari:

a) respekton dhe punon për një gjyqësor të pavarur, si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin institucional;

b) kujdeset gjithmonë që sjellja e tij, zyrtare apo private, të mos cenojë pavarësinë individuale apo institucionale të gjyqësorit dhe as dukjen e pavarësisë në sytë e publikut. Gjyqtari duhet të shmangë sjelljet që mund të krijojnë përshtypjen te publiku se është i angazhuar politikisht dhe as të marrë pjesë në aktivitete politike, në çfarëdo lloji mënyrë, me përjashtim të çështjeve me rëndësi për funksionimin e gjykatave dhe pavarësinë e tyre;

c) nuk duhet të japë kontribute financiare apo kontribute të tjera subjekteve politike dhe as të nënshkruajë peticione që ndërmerren nga subjekte politike;

ç) kujdeset që të jetë i pavarur nga kolegët e tij. Ai mund të këshillohet me kolegët gjyqtarë, por përgjegjësia në vendimmarrje është vetëm e tij;

d) duhet të mos ndikohet nga reagimi publik, që mund të shkaktojë veprimtaria e tij;

dh) mund të refuzojë gjykimin e një çështjeje ku mund të vihet në diskutim pavarësia e tij, pavarësisht nëse kjo kërkohet apo jo nga palët.

B. Parimi i paanshmërisë

7. Në kryerjen e detyrave gjyqësore gjyqtari është i paanshëm dhe duhet të duket i tillë. Gjyqtari gjykon me paanësi, i lirë nga çdo lidhje, prirje ose paragjykim që ndikon, ose mund të duket se ndikon, në aftësinë e tij për të gjykuar në mënyrë të

paanshme. Në këtë kuptim, paanësia duhet të jetë e dukshme gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore të gjyqtarit dhe aktiviteteve të tjera të tij në jetën private. Sipas këtij parimi gjyqtari:

a) merr masa që sjellja e tij në gjykatë dhe jashtë saj të garantojë dhe rrisë besimin e publikut, praktikuesve të tjerë të ligjit dhe të palëve tek vetë gjyqtari dhe gjyqësori;

b) shmang çdo lloj sjelljeje që mund të krijojë përshtypjen e anshmërisë;

c) nuk duhet të lejojë që gjykimi i tij të ndikohet nga presioni, frika, mendimi personal apo paragjykim, nga ide paraprake mbi çështjen që ka për gjykim dhe as të promovojë në mënyrë të papërshtatshme interesat e një pale, në dëm të palës tjetër;

ç) shmang situatat që në mënyrë të arsyeshme mund të perceptohen se çojnë drejt një konflikti interesi;

d) mund të mos marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje, nëse ai çmon se nuk është në gjendje të gjykojë në mënyrë të paanshme ose një vëzhguesi të arsyeshëm mund t'i krijohej përshtypja që gjyqtari nuk është në gjendje ta gjykojë çështjen në mënyrë të paanshme;

dh) brenda kufijve të arsyeshëm, vepron në mënyrë të tillë që të minimizohen rastet ku do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes;

e) përveç rasteve të parashikuara me ligj, gjyqtari nuk duhet të iniciojë, lejojë apo të konsiderojë komunikimin *ex parte* jashtë seancës gjyqësore. Në rast se ndodh një komunikim i tillë, gjyqtari e ndan informacionin përkatës me palët e tjera të përfshira dhe kur është e mundur, siguron pjesëmarrjen e tyre, duke u dhënë mundësinë për t'u shprehur, nëse kërkohet;

ë) duhet të tregojë vetëpërmbytje në mbështetjen publikisht apo shprehjen e kritikave të çfarëdo lloji dhe natyre ndaj pushteteve të tjera, përveç çështjeve që lidhen me reformën dhe funksionimin e gjyqësorit;

f) duhet të shmanget nga bërja e komenteve mbi çështje të diskutueshme politike apo deklarata publike, të cilat mund të krijojnë përshtypjen se gjyqtari është i njëanshëm ose i ndikuar në një çështje të caktuar;

g) duhet të jetë i kujdesshëm në marrëdhëniet që krijon për shkak të anëtarësisë së tij në shoqatat e gjyqtarëve apo në shoqata kulturore, sportive,



fetare ose të fushave të tjera duke shmangur ato marrëdhënie që mund të komprometojnë respektimin e imazhit të tij ose të sistemit gjyqësor;

gj) nuk duhet të pranojë dhurata, favore apo përfitime, për veten apo të afërmit e tij, të tilla që mund të venë në diskutim paanshmërinë e tij;

h) nuk lejon që banesa apo çdo ambient privat në posedim faktik prej tij të përdoret nga avokatët ose praktikues të tjerë të ligjit për të pritur klientët e tyre.

C. Parimi i integritetit

8. Gjyqtari sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në funksion dhe paanshmërinë e pavarësinë e gjyqësorit. Sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarit duhet të rikonfirmojë besimin e qytetarëve tek integriteti i gjyqësorit. Sipas këtij parimi, gjyqtari:

a) kujdeset për ruajtjen e integritetit si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor;

b) sigurohet që sjellja e tij të jetë dinjitoze në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm;

c) nuk lejon që marrëdhëniet familjare, shoqërore apo të tjera, të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen apo ushtrimin e detyrës së tij;

ç) duhet të udhëhiqet nga mirësjellja dhe ndershmëria profesionale, korrektesa në marrëdhëniet e tij me kolegët, administratën gjyqësore, palët në proces dhe përfaqësuesit e tyre, medien dhe publikun;

d) shmang sjelljet që bien në kundërshtim me ligjin dhe bën përpjekje që të shmangë çdo sjellje që tregon mungesë ndjeshmërie apo kujdesi;

dh)shmang çdo përfitim personal, për vete, familjarë apo të tjerë, që i vijnë për shkak të detyrës si gjyqtar dhe nuk lejon me vetëdije që të tjerët të japin përshtypjen se kanë një pozicion të veçantë për të pasur ndikim të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit;

e) nuk kërkon dhe as pranon dhurata, hua apo favore për vete ose anëtarët e familjes së tij, që i vijnë për shkak të ushtrimit të detyrës;

ë) nuk lejon me vetëdije anëtarët e familjes, personelin e gjykatës apo të tjerë, të kërkojnë ose pranojnë dhurata, hua apo favore, që iu bëhen për shkak të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit;

f) mund të marrë dhurata simbolike, çmime ose përfitime, sipas rastit për të cilin jepet, me kusht që

dhurata, çmimi apo përfitimi, të mos perceptohen nga një vëzhgues i arsyeshëm, si shkak njëanshmërie apo si qëllim për të ndikuar te gjyqtari në ushtrimin e detyrës;

g) mund të pranojë dekorime dhe tituj nderi, vetëm kur pranimit i tyre nuk ngre dyshime të arsyeshme për njëanshmëri ose cenim të pavarësisë së gjyqtarit.

Ç. Parimi i sjelljes së hijshme dhe me vetëpërmbytje

9. Gjyqtari shmang sjelljen e pahijshme dhe shfaqjen e saj në të gjitha aktivitetet e tij. Si subjekt i vëzhgimit të vazhdueshëm publik, gjyqtari duhet të pranojë kufizime personale që mund të shihen si të paarsyeshme për një qytetar të thjeshtë dhe këtë duhet ta bëjë lirshëm dhe me dëshirë. Gjyqtari shmang çdo sjellje, e cila krijon dyshimin e arsyeshëm se vendimet e tij nxiten nga motive të tjera, përtej zbatimit të drejtë të ligjit. Gjyqtari sillet me vetëpërmbytje me synim arritjen e një balance mes të drejtave të tij si qytetar dhe kufizimeve që lidhen me funksionin e tij. Sipas këtij parimi, gjyqtari:

a) përpiket në maksimum të mos cenojë besimin që publiku ka tek ai në ushtrimin e detyrës dhe në jetën e tij private;

b) duhet të respektojë dinjitetin e funksionit. Si çdo qytetar tjetër, ai gëzon lirinë e shprehjes, besimit, tubimit dhe organizimit, por në ushtrimin e këtyre të drejtave, ai duhet të sillet gjithmonë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin e funksionit, paanshmërinë dhe pavarësinë e gjyqësorit. Ai tregon po të njëjtin kujdes kur përballlet me kritika apo sulme;

c) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera të ndryshme nga ato që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore;

ç) mban veshur togën gjyqësore gjatë ushtrimit të funksionit në salla gjykimi apo hapësira të tjera që i zëvendësojnë ato, ndërsa në raste të tjera, gjatë kohës së punës ose kur vepron si përfaqësues i gjyqësorit, u përmbahet rregullave të veshjes formale;

d) duhet t'i kërkojë personelit administrativ të gjykatës që mbështet veprimtarinë e tij gjyqësore, të zbatojë për aq sa është e mundur, rregullat e këtij Kodi gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Një gjyqtar nuk duhet të orientojë personelin e gjykatës që të angazhohet në veprime në emër të gjyqtarit ose si përfaqësues i tij, kur kjo sjellje do të binte ndesh me



këtë Kod nëse këto veprime do të kryheshin nga vetë gjyqtari;

dh) nuk duhet të përdorë informacionin konfidencial për të cilin gjyqtari vihet në dijeni, për shkak të detyrës apo ta zbulojë atë për ndonjë qëllim tjetër që nuk lidhet me ushtrimin e detyrës;

e) nuk mund të nxisë krijimin, pjesëmarrjen ose të anëtarësohet në ndonjë organizatë që mbështet çfarëdolloj diskriminimi, kërkon betim solemn për besnikëri, nuk ka transparencë të anëtarësisë apo që mban qëndrim denigrues ndaj gjykatave ose shtetit demokratik dhe të së drejtës;

ë) nuk mund të përfshihet në një veprimtari apo organizata që shfrytëzojnë anëtarësinë e gjyqtarit për të përfituar;

f) nuk duhet të shfrytëzojë pozitën e tij si gjyqtar për mbledhjen e mjeteve financiare, kur ai merr pjesë në aktivitete shoqërore, bamirësie apo fetare;

g) duhet të shmangë shfaqjen e bindjeve të tij politike edhe pse ai si çdo qytetar, gëzon të drejtën për të pasur të tilla;

gj) duhet të shfaqë vetëpërmbytje edhe në marrëdhëniet e tij me median. Për çështje që lidhen me marrëdhëniet me median, gjyqtari komunikon me gjyqtarin e medias të juridiksionit përkatës, duke shmangur çdo shfrytëzim të njohjeve personale me gazetarët;

h) vetëpërmbahet dhe nuk i komenton publikisht vendimet e tij, edhe nëse ato kritikohen nga medie apo akademikë, ose prishen nga gjykatat më të larta. Gjyqtari e shpreh mendimin e tij vetëm në arsyetimin e vendimit të marrë;

i) nuk duhet të publikojë, në asnjë formë, si kontribut personal apo akademik, vendimet gjyqësore të dhëna prej tij si gjyqtar i vetëm apo si pjesë e trupës gjyqësore, me përjashtim të rastit kur pjesë të vendimit citohen për qëllime debati akademik, sipas rregullave të referimit;

j) mund të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me sistemin gjyqësor dhe mund të bëjë vetëm deklaratat të përgjithshme, në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete. Gjyqtari mund të marrë pjesë edhe në aktivitete që nxitin vlerat qytetare, edukuese, fetare, bamirësie, si dhe mund të bëjë deklaratat përgjithshme vetëm në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete, por pa cenuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit;

k) shfaq vetëpërmbytje në përdorimin e medias dhe rrjeteve sociale;

l) duhet të mos e përdorë statusin e tij si gjyqtar në jetën e tij private. Ai nuk duhet të krijojë përshtypje që do të ushtrojë pushtet mbi palët e treta, apo t'i bëjë ata që të mendojnë se gjyqtari, edhe në nivel personal, ka të drejtë të ushtrojë pushtetet që ia atribuon ligji gjatë veprimtarisë dhe administrimit gjyqësor.

D. Parimi i kujdesit të duhur dhe profesionalizmit

10. Gjyqtari i kryen me kujdes dhe efikasitet detyrat e tij në kohë dhe pa vonesë. Funkcionet gjyqësore ushtrohen me nivelin më të lartë të aftësive profesionale. Profesionalizmi, sikundër edhe kujdesi i duhur, janë parakushte për kryerjen e detyrave gjyqësore. Ushtrimi i funksioneve nga ana e gjyqtarit ka përparësi mbi të gjitha aktivitetet e tjera. Sipas këtij parimi, gjyqtari:

a) i trajton dhe gjykon çështjet brenda një afati të arsyeshëm të përshtatshëm për çështjen në fjalë, pa cenuar cilësinë e vendimit. Për secilën procedurë, atje ku ligji nuk parashikon shprehimisht, ai kujdeset që të përcaktojë afate të arsyeshme për palët dhe për veten e tij;

b) siguron administrim të drejtë të procesit gjyqësor dhe ndërvepron me profesionalizëm me administratën gjyqësore;

c) i kushton kujdes çdo pretendimi të bërë për shkeljen e të drejtave të një pale ose të një dëshmitari, duke përfshirë edhe pretendimet për keqtrajtimit;

ç) ia kushton veprimtarinë profesionale ushtrimit të funksionit dhe administrimit të drejtësisë;

d) kujdeset që angazhimi i tij në veprimtari jashtëgjyqësore të mos cenojë kryerjen me përkushtim të detyrave gjyqësore;

dh) synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë nivele të larta të aftësive profesionale;

e) ndërmer hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe rritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për kryerjen e detyrave gjyqësore;

ë) kujdeset për zhvillimin e aftësive të tjera, në përshtatje të risive teknologjike që ndikojnë në punën e tij;

f) informohet rregullisht në lidhje me zhvillimet e së drejtës ndërkombëtare, të detyrueshme për zbatim në Republikën e Shqipërisë;

g) bashkëpunon dhe ndërvepron me kolegët për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive profesionale;



gj) duhet të shfaqë përkushtim të posaçëm ndaj përgjegjëseve të tij si kryetar apo zëvendëskryetar i Gjykatës, krahas veprimtarisë së tij gjyqësore. Gjyqtari me funksion drejtues duhet të tregojë shkallë të lartë përgjegjësie, aftësi organizative, drejtuese dhe komunikimi më të gjithë përdoruesit e gjykatës. Ai duhet të marrë masa për të garantuar aksesin e publikut në gjykatë, duke përfshirë edhe aksesin për personat me aftësi ndryshe;

h) gjatë ushtrimit të funksionit drejtues, në marrëdhënie me të tretët, duhet të mbrojë imazhin e drejtësisë, të tregojë seriozitetin dhe dinjitetin që publiku pret nga sistemi gjyqësor.

DH. Parimi i respektit dhe aftësisë për të dëgjuar

11. Gjyqtari duhet të tregojë respekt dhe vëmendje ndaj personave dhe dinjitetit të tyre. Ai duhet t'i kushtojë vëmendje prezantimit të fakteve dhe arsytimit ligjor të paraqitur nga palët dhe mbrojtësit e tyre. Sipas këtij parimi gjyqtari:

a) sillet në një mënyrë dinjitoze, korrekte, të respektueshme dhe mirëkuptuese në marrëdhëniet e tij me përdoruesit e gjykatës, kolegët e tij dhe stafin administrativ;

b) dëgjon me vëmendje dhe merr parasysh në organizimin e punës së tij, kërkesat e të gjithë atyre që preken nga çështja;

c) synon të krijojë një atmosferë të qetë në çdo ambient të gjykatës që përdor për ushtrimin e funksionit;

ç) mban marrëdhënie korrekte me kolegët duke respektuar mendimin e tyre;

d) respekton ushtrimin e detyrave dhe kompetencave prej stafit administrativ;

dh) siguron që vlerat e respektit dhe të dëgjuarit të ndahen dhe respektohen nga të gjithë, gjatë kryerjes së detyrave të tij administrative.

E. Parimi i trajtimit të barabartë

12. Trajtimi i barabartë i qytetarëve nga gjykata është thelbësor për performancën e duhur të sistemit gjyqësor. Sipas këtij parimi, gjyqtari:

a) përmbush funksionet e tij në respekt të plotë të parimit të trajtimit të barabartë të palëve. Ai shmang çdo paragjykim dhe diskriminim duke siguruar që çdo palë të dëgjohet në seancë në mënyrë të ekuilibruar;

b) synon të shmangë situatat në të cilat individët mund të ndiejnë se po ndërmerret një qasje e njëanshme dhe t'i adresojë këto situata në një

mënyrë që të rritë besimin dhe respektin e publikut për gjykatën;

c) respekton individualitetin e gjithsecilit, duke garantuar trajtimin e barabartë si gjatë proces, ashtu edhe në përfundim të çështjes;

ç) sillet në mënyrë të tillë që askujt të mos i krijohet përshtypja se është injoruar, përkrahur apo përbuzur;

d) duhet të përcjellë te gjyqtari i medias në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të gjitha informacionet që ky i fundit ndan me median dhe publikun.

Ë. Parimi i transparencës

13. Publiku duhet të informohet mbi funksionimin e sistemit gjyqësor. Sipas këtij parimi gjyqtari:

a) arsyeton vendimet e tij në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme;

b) siguron transparencë përmes seancave publike, në ruajtje të konfidencialitetit dhe respektimit të privatësisë ose rendit publik;

c) nuk abuzon me kërkesën për transparencë për ta shndërruar ushtrimin e funksionit në një shfaqje publike.

III. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË KODIT TË ETIKËS

14. Çdo gjyqtar ka të drejtë të kërkojë nga Këshilltari për Etikën një opinion këshillimor për çështje të diskutueshme të etikës, lidhur me sjellje apo veprime të caktuara gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, nëse ato konsiderohen ose jo në pajtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes. Interpretimi i standardeve etike dhe i rregullave të sjelljes nga Këshilltari për Etikën, lidhur me faktin nëse rregulli përkatës e lejon një sjellje të caktuar, mund të përdoret si mjet mbrojtjeje nga ana e gjyqtarit në rast procedimi disiplinor, por ky interpretim nuk ka karakter detyrues për zgjidhjen e rasteve të tjera të ngjashme nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

15. Kryetari i gjykatës mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe raporton çdo problematikë në Këshillin e Lartë Gjyqësor në kuadër të informacionit periodik që i kërkohet.

16. Shkelja e rregullave të këtij Kodi kur nuk përbën shkak për përgjegjësi disiplinore merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.



**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT
TË DEKLASIFIKUAR NË DREJTORINË E
SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR (DSIK)**

Nr. 96, datë 21.4.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar; VKM-n nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, dhe në udhëzimin e drejtorit të DSIK-së nr. 99, datë 13.4.2017, “Për zbatimin e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017, Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”; Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) në DSIK, ka deklasifikuar informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror” si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht raportet e Grupit të Punës (GP) në DSIK, informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i GP nr. 12448, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Alma Tomorr Ahmeti**”.

2. Raport i GP nr. 11606, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Arta Guri Duka**”.

3. Raport i GP nr. 12365, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Dhurata Bilal Bilo**”.

4. Raport i GP nr. 12065, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Elida Hekuran Hoxhaj**”.

5. Raport i GP nr. 12442, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Elona Nesti Mihali**”.

6. Raport i GP nr. 11587, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Eriselda Baki Bala**”.

7. Raport i GP nr. 11998, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Esmeralda Ndoc Ndoci**”.

8. Raportet e GP nr. 12231, datë 2.11.2017 dhe nr. 10560, datë 18.11.2020, me lëndë: “Dërgohet

raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Florjan Ylli Kalaja**”.

9. Raport i GP nr. 12233, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Gentian Luigj Marku**”.

10. Raport i GP nr. 12339, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Lutfije Hazis Celami**”.

11. Raport i GP nr. 11668, datë 30.1.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Luveda Luan Dardha**”.

12. Raport i GP nr. 11730, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Maria Qëndro Qirjazi**”.

13. Raport i GP nr. 11789, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Mariana Spiro Shegani**”.

14. Raport i GP nr. 12327, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Marinela Kristaq Osmani**”.

15. Raport i GP nr. 11794, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Marsela Agim Dervishi**”.

16. Raport i GP nr. 11864, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Marsela Hekuri Pepi**”.

17. Raport i GP nr. 12404, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Olsi Stavraq Xhavella**”.

18. Raport i GP nr. 11436, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Oltjona Flatur Goxha**”.

19. Raport i GP nr. 11424, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Qemal Petrit Zaimi**”.

b) Deklasifikoi pjesërisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i GP nr. 12089, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Amarildo Ahmet Laçi**”.

2. Raport i GP nr. 10973, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Arian Zef Ndoja**”.



3. Raport i GP nr. 8456, datë 18.9.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Bledar Sadik Bejko**”.

4. Raport i GP nr. 10972, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Bujar Mustaf Memia**”.

5. Raport i GP nr. 11718, datë 23.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Dhurata Bilal Bilo**”.

6. Raport i GP nr. 10855, datë 24.11.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Dritan Adem Gina**”.

7. Raport i GP nr. 10976, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Enkeleda Laze Doda**”.

8. Raport i GP nr. 10971, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Ergys Luan Selmani**”.

9. Raport i GP nr. 12492, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Etleva Skënder Gjamo (Çami)**”.

10. Raport i GP nr. 10974, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Hysni Rexhep Mulaj**”.

11. Raport i GP nr. 10854, datë 24.11.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Jak Pashko Ndoka**”.

12. Raport i GP nr. 10970, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Julian Hajdar Çafka**”.

13. Raportet e GP nr. 10462, datë 13.11.2020 dhe nr. 10758, datë 24.11.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Klajdi Mihal Mone**”.

14. Raport i GP nr. 11185, datë 7.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Klodiana Begator Gjyzari**”.

15. Raport i GP nr. 8455, datë 18.9.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Leonard Bardhok Filopati**”.

16. Raport i GP nr. 8350, datë 17.9.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **zj. Lutfije Hazis Celami**”.

17. Raport i GP nr. 10977, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Piro Kiço Sota**”.

18. Raport i GP nr. 10975, datë 1.12.2020, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit **z. Taulant Dhimitër Tafa**”.

c) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në *web* të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM
Nr. 90, datë 6.4.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SHA, NË AKTIVITETIN
E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR
(SHITJE ME PAKICË)**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5 dhe nenit 12, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 97, datë 4.7.2017, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 40/7 prot., datë 2.4.2021 dhe atë nr. 40/7-1 prot., datë 5.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7362 prot., datë 24.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 291/8 prot., “Albpetrol” sh.a., datë 24.12.2020, ka kërkuar shtyrjen e afatit të depozitimit të dokumentacionit, në lidhje me aplikimin për licencën e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë) me 3 (tre) muaj, duke filluar nga data 31.12.2020, pasi ky ka qenë afati i përcaktuar në vendimin nr. 120/2020, brenda të cilit duhej të depozitonte



dokumentacionin e munguar e më pas deri në datën 6.1.2021, u konsiderua koha që ERE-s i duhej për të përgatitur praktikën për trajtim në Bord.

- Në vijim të kësaj kërkesë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 11.1.2021, vendosi për zgjatjen e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për 3 (tre) muaj, duke filluar nga data 6.1.2021 deri në datën 6.4.2021.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresat e protokolluara në ERE nr. 120/1 prot., datë 29.3.2021, nr. 120/2 prot., datë 29.3.2021 dhe nr. 120/4 prot., datë 1.4.2021, ka përcjellë kryesisht dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka kryer pagesën e aplikimit, sipas kërkesave të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 97, datë 4.7.2019.

- Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- neni 9, “Formati i aplikimit”;

- pika 1, germa “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- germa “d”, “Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor”, pikat “i”, “iii”, “iv”, “v”: plotësuar.

- germa “e”, “Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale”, pikat “i”, “ii”, “iii”, “iv”, “v”, “vi”, “vii”: plotësuar.

- pika 2, “Dokumente specifike për llojin e licencës”, germa “f”, “Licencë për furnizim me gaz natyror”, pikat “i”, “ii”, “iii”: plotësuar.

Në lidhje me dokumentacionin e paplotësuar dhe atë të plotësuar pjesërisht si më poshtë, në këtë vendim do të përcaktohen kushte:

Neni 9, pika 1, “Forma e aplikimit”:

- Germa “d”, “Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor”

ii) (Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare që nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.) Shoqëria nuk ka depozituar vërtetim të prokurorisë dhe as vërtetim të gjykatës për shoqërinë tregtare:

plotësuar pjesërisht. Duke qenë se vërtetimet mbajnë data të hershme dhe si rezultat i ndërrimit të administratorit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë për administratorin e ri të saj, dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për vetë shoqërinë, me data të përditësuara. Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën nr. 2190/1 prot., datë 1.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 120/4 prot., datë 1.4.2021, ka bërë me dije se ka aplikuar për këto vërtetime dhe do t'i depozitojë në ERE sapo t'i disponojë.

vi) (Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për aplikantin, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore, sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse: plotësuar pjesërisht.) Duke qenë se këto dokumente janë depozituar në ERE në formatin fotokopje dhe fotokopje të njësuar me vulën e vetë “Albpetrol” sh.a., vlerësojmë vendosjen e një kushti në dispozitivin e vendimit, në mënyrë që shoqëria t'i përcjellë ato në formën e kërkuar nga neni 8, pika 3, e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Germa “e”, “Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale”:

i. Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit: pa plotësuar. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente për këtë kërkesë të rregullores, por me shkresën nr. 2190/1 prot., datë 1.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 120/4 prot., datë 1.4.2021, ka bërë me dije se ka aplikuar për këto vërtetime dhe do t'i depozitojë në ERE sapo t'i disponojë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar, me kusht që brenda 3 (tre) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitojë në ERE:



a) vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë për administratorin e ri të saj, dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për vetë shoqërinë “Albpetrol” sh.a., me data të përditësuara;

b) deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe të sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit;

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të depozitojë në ERE përpara fillimit të operimit dokumentacionin pronësor dhe Lejet mjedisore në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 91, datë 6.4.2021

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 35, DATË 4.2.2021

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67, nenit 92, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.

40/2 prot., datë 31.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 4.2.2021, vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. nr. 64, seria NPM08P.

3. Shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimmarrje të Bordit nëpërmjet shkresës nr. 51/2 prot., datë 11.2.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.

- Sa më sipër, brenda afatit 30-ditor, brenda të cilit shoqërisë i është dhënë e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar në ERE shkresën nr. 06/21 prot., datë 3.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 51/4 prot., datë 5.3.2021, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

- Në mbështetje të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit nr. 35/2021, shoqëria ka paraqitur argumentet dhe dokumentacionin shoqëruar.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatitin një relacion për bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t’i paraqesin Bordit propozimin përkatës.

- Në përmbushje të afatit 30-ditor për të përgatitur relacionin përkatës mbi argumentet e paraqitura nga shoqëria, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë për rishikimin e vendimit të



Bordit të ERE-s nr. 35/2021, me qëllim që t'i jepet mundësia asaj të depozitojë në ERE dokumentacionin vërtetues mbi sa deklarohet nga ana e saj, si dhe për sqarime të mëtejshme apo dokumente shtesë në lidhje me kërkesën e parashtruar.

- Në nenin 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet, se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar, sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Biopower Green Energy” sh.p.k. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 92, datë 6.4.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER” SHPK, PËR TRANSFERIM TË ASETVEVE (VENDOSJE HIPOTEKE, RISTRUKTURIM KREDIE), NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK” SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, pika “a”; nenit 44, pika “1”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe

në zbatim të nenit 11, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të Kushteve të Licencës, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 40/4 prot., datë 1.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

- Me shkresën nr. 70 prot., datë 14.1.2021, shoqëria paraqiti në ERE kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, në pamundësi për ta plotësuar atë në afat, për shkak edhe të situatës së vështirë të krijuar nga COVID-19 dhe vonesave të shkaktuara për marrjen e dokumentacionit nga banka.

- Në lidhje me këtë kërkesë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 12, datë 20.1.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

- Më tej, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 127/1 prot., datë 10.2.2021, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të munguar, duke mos ezauruar plotësisht kërkesat e rregullores së transferimit të aseteve.

- Në vijim të depozitimit për trajtimin në Bord të relacionit përfundimtar nr. 33/2 prot., datë 1.3.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Seman Sunpower’ sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të ‘Intesa Sanpaolo Bank’ sh.a.”, në ERE mbërriti shkresa e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., nr. 127/2 prot., e



ERE-s, datë 2.3.2021, me lëndë: “Plotësim dokumentacioni”.

- Duke qenë se shoqëria depozitoi dokumentacionin, i cili kërkonte kohë për njohje dhe analizim, në prag të përfundimit të afatit të vendimmarrjes së ERE-s, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 4.3.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., në mënyrë që të merrej koha e mjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria.

- Vendimi nr. 64/2021 iu njoftua shoqërisë me shkresën nr. 127/3, datë 9.3.2021 dhe me shkresën nr. 127/4 prot. të datës 24.3.2021, me lëndë: “Vijim komunikimi”; ERE i kërkoj shoqërisë ndër të tjera listën e qartë të aseteve me vlerat përkatëse, si pjese integrale të marrëveshjes që “Seman Sunpower” sh.p.k. ka nënshkruar me bankën.

- Shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k., me shkresën “Plotësim dokumentacioni”, të protokolluar në ERE me nr. 127/5 prot., datë 30.3.2021, ka paraqitur listën e aseteve të paluajtshme bashkëlidhur Kontratës së hipotekimit, me vlerën respektive.

- Nga analizimi i dokumentacionit të këtij aplikimi, në fazën përfundimtare të miratimit, duke marrë në konsideratë edhe sa plotësohet më parë prej saj në këtë aplikim (pasqyruar në relacionin nr. 33/2, datë 1.3.2021), dokumentacioni rezulton tërësisht i plotësuar, sipas kërkesave të parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- neni 7, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”: plotësuar;

- neni 7, pika 3: plotësuar;

- neni 7, pika 4: plotësuar;

- neni 7, pika 6: plotësuar;

- Shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 404, seria PV18, dhënë me vendimin nr. 86, datë 20.4.2018, të Bordit të ERE-s, për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas) me kapacitet të instaluar 2000 kw.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. (bashkëlidhur lista e aseteve me vlerat përkatëse).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

Në bazë të aneksit 3, “Lista e aseteve”, më poshtë vlera e këtyre aseteve:

Emri i asetit	Vlera euro pa TVSH
Module Pv	763,940.33
Struktura	352,564.88
Inverter	213,993.27
Combiner box	116,015.27
Transformer	196,814.27
	1,643,328.00

VENDIM
Nr. 93, datë 6.4.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“GERTI” SHPK, PËR ZGJATJEN E
AFATIT TË VENDIMMARRJES SË ERE-s
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GERTI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “VARDARI” ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave



Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 40/5 prot., datë 1.4.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të vendimarrjes së ERE-s për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 20.1.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendndodhje në Përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Në mbledhjen e Bordit të datës 22.2.2021 u relatua relacioni nr. 30/3, datë 16.2.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kw”.

- Nga ana e Bordit të ERE-s u konstatua nevoja e kerkimit të informacionit, në lidhje me përthithjen e të drejtave të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., nga “Gerti” sh.p.k., në vijim të “Amendim kontrate” nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, me anë të së cilës të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., i janë transferuar shoqërisë “Gerti” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 58, datë 22.2.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për dokumentimin nga aplikuesi, në lidhje me sa konstatuar më lart.

- Në vijim të kësaj vendimarrjeje ERE i është drejtuar shoqërisë “Gerti” sh.p.k., me shkresën nr. 405 prot., datë 2.3.2021, me anë të së cilës i kërkoi depozitimin e dokumentacionit që vërteton kryerjen e transferimit të lejes së ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria

“Gerti” sh.p.k.; Dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes mjedisore nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.; Kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar; “Marrëveshjen e lidhjes së re” të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a., me palën e zëvendësuar; Dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe të administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 mw.

- Duke qenë se nga ana e shoqërisë nuk kishte asnjë përgjigje, ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 405/1 prot., datë 24.3.2021, duke i kujtuar edhe njëherë detyrimin për të përcjellë në ERE sa më sipër.

- Ndërkohë, përpara përfundimit të afatit të caktuar nga Bordi, me vendimin nr. 58/2021, shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405/2 prot., datë 30.3.2021, ka kërkuar shtyrjen e afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s për paraqitjen e dokumentacionit të lëshuar nga institucionet përkatëse, pasi nuk janë siguruar ende (varen nga vendimet e institucioneve respektive), edhe pse kjo e fundit ka aplikuar në kohë për ndryshimin e emrit të subjektit, sipas kërkesave dhe sipas saj kjo e drejtë sigurohet nga kontrata e transferimit të të drejtave me MIE-n.

- Kërkesa e “Gerti” sh.p.k. rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se:

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Ndodhur në të tilla rrethana, kur shoqëria jo për fajin e saj, nuk ka mundur të sigurojë dokumentacionin e kërkuar, vlerësojmë/sugjerojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s, në mënyrë që t'i jepet shoqërisë “Gerti” sh.p.k.



mundësia për t'u pajisur me këto dokumente dhe t'i depozitojë ato në ERE.

Për gjithë sa me sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 60 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. të paraqesë brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi:

a) dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes së ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.;

b) dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes mjedisore nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.;

c) kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., dhe Bashkisë Librazhd, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar;

d) “Marrëveshjen e lidhjes së re” të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a. me palën e zëvendësuar;

e) dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari” me kapacitet 1.972 mw.

3. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 94, datë 6.4.2021

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 41, DATË
6.3.2020, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘KROI MBRET ENERGJI’
SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC ‘BACKA 1’ ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kw,
HEC ‘BACKA 2’ ME KAPACITET TË
INSTALUAR 4000 kw, HEC ‘BACKA A’ ME
KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw,
HEC ‘BACKA B’, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 500 kw, HEC ‘BACKA C’ ME
KAPACITET TË INSTALUAR 720 kw, ME
KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR
7320 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 40/6 prot., datë 2.4.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC: ‘Backa 1’ me kapacitet të instaluar 1600 kw, ‘Backa 2’ me kapacitet të instaluar 4000 kw, ‘Backa A’ me kapacitet të instaluar 500 kw, ‘Backa B’ me kapacitet të instaluar 500 kw dhe ‘Backa C’ me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 41, datë 6.3.2020, vendosi:

“1. Të licencoje shoqërinë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC: ‘Backa 1’ me kapacitet të instaluar 1600 kw, ‘Backa 2’ me kapacitet të instaluar 4000 kw, ‘Backa A’ me kapacitet të



instaluar 500 kw, ‘Backa B’ me kapacitet të instaluar 500 kw dhe ‘Backa C’ me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor.

2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.”.

- Në plotësim të kushtit të sipërcituar, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me shkresën nr. 422 prot., datë 31.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 467/2 prot., datë 31.3.2021, në përmbushje të kushtit të vendimit të sipërcituar, ka përcjellë lejet si vijon:

- lejen nr. 184, datë 22.3.2021, miratuar me vendimin nr. 3, datë 12.3.2021, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman, “Për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor” dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC “Backa A”, me prurje mesatare vjetore 87 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit;

- lejen nr. 186, datë 22.3.2021, miratuar me vendimin nr. 4, datë 12.3.2021, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman, “Për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor” dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC “Backa C”, me prurje mesatare vjetore 478 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit;

- lejen nr. 186, datë 22.3.2021, miratuar me vendimin nr. 5, datë 12.3.2021, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman, “Për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor” dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC “Backa 1”, me prurje mesatare vjetore 820 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit.

- Sa më sipër, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC: ‘Backa 1’ me kapacitet të instaluar 1600 kw, ‘Backa 2’ me kapacitet të instaluar 4000 kw, ‘Backa A’ me kapacitet të instaluar 500 kw, ‘Backa B’ me kapacitet të instaluar 500 kw dhe ‘Backa C’ me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw”.

- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument që ka të dhëna se duhet t’i nënshtrohet procedurës së rinovimit. Kjo referuar edhe konstatimeve të vendimit përkatës të licencimit nr. 41/2020. Për rrjedhojë, aktualisht shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, ndryshon si vijon:

Ishte:

“1. Të licencojë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC: “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kw, “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw, “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kw dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor.”.

Bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC: “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kw, “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw, “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kw dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj.”.

2. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 95, datë 6.4.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGIJ” SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 461/1, SERIA P20, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 41, DATË 6.3.2020, “PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘BACKA 1’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kw, HEC ‘BACKA 2’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000 kw, HEC ‘BACKA A’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC ‘BACKA B’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC ‘BACKA C’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 720 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 13 dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 40/8 prot., datë 2.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energi” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 69, datë 12.3.2021, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energi” sh.p.k., nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 3889 rep., nr. 959 kol., datë 27.7.2020, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim – operim – transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’ dhe ‘Backa C’”.

- Në vijim të vendimarrjes së ERE-s, me njoftimin nr. 6/10 prot., datë 13.3.2021, është bërë publikimi në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për këtë modifikim dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezultoi të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 467 prot., datë 24.3.2021, ka njoftuar shoqërinë “Kroi Mbret Energi” sh.p.k., lidhur me vendimarrjen e Bordit, për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 69/2021.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energi” sh.p.k., me shkresën nr. 51/1 prot., datë 30.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 467/1, datë 30.3.2021, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Modifikimi i licencës nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, sipërcituar, ka ardhur për arsye se kanë ndodhur ndryshime në karakteristikat e HEC, ku nga 5 (pesë) HEC-e do të jenë 3 (tre) HEC-e, konkretisht HEC “Backa 1”, “A”, “C”.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën nr. 3059/4 prot., datë 18.6.2020, drejtuar shoqërisë “Kroi Mbret Energi” sh.p.k., për dijeni AKBN-së, ka miratuar projektin e zbatimit përfundimtar (të ndryshuar) të HEC “Backa 1”, “A”, “C”.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Kroi Mbret Energi” sh.p.k. dhe MIE kanë lidhur kontratën shtesë të koncesionit me nr. 3889 rep., nr. 959 kol., datë 27.7.2020, “Për disa ndryshime në kontratën e



koncesionit të formës BOT (ndërtim – operim – transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar tërësisht, si vijon:

Neni 9, pika 1, formati i aplikimit:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar;
- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), plotësuar;
- germa “c” (të dhëna për aplikuesin), plotësuar.

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- germa “a” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës), plotësuar;

- germa “b” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës), plotësuar;

- germa “c” (miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera), plotësuar;

- germa “d” (ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi), plotësuar;

- germa “e” (të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE), plotësuar.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në kuadër të modifikimit të licencës, ka përcjellë në ERE edhe shkresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr. 4314/1 prot., datë 31.8.2020, “Mbi procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis”, me anë të së cilës konfirmohet nga AKM-ja se projekti është i vlefshëm, pasi veprimtaria ka filluar zbatimin në terren brenda afatit të marrjes së deklaratës mjedisore.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në kuadër të modifikimit të licencës, me shkresën nr. 422 prot., datë 31.3.2021, protokolluar në ERE me nr. 467/2 prot., datë 31.3.2021, ka përcjellë edhe lejet si vijon:

- lejen e shfrytëzimit të burimit ujor nr. 184, datë 22.3.2021, miratuar me vendimin nr. 3, datë 12.3.2021, të Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor”, dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC “Backa A”, me prurje mesatare vjetore 87 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit;

- lejen e shfrytëzimit të burimit ujor nr. 186, datë 22.3.2021, miratuar me vendimin nr. 4, datë 12.3.2021, të Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor”, dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC “Backa C”, me prurje mesatare vjetore 478 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit;

- lejen e shfrytëzimit të burimit ujor nr. 186, datë 22.3.2021, miratuar me vendimin nr. 5, datë 12.3.2021, të Këshillit të Basenit Ujor Seman, “Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor”, dhënë shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., për HEC “Backa 1”, me prurje mesatare vjetore 820 l/s, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, për prodhim hidroenergjie, me afat sipas kontratës së koncesionit.

- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, për informacion rreth vlefshmërisë së “Marrëveshjes për lidhje të re”, që ka nënshkruar me OSSH sh.a., në kuadër të ndryshimeve të karakteristikave të HEC, të cilat prekin kapacitetin total të instaluar, dhe gjithashtu nëse shoqëria ka nënshkruar aktualisht një kontratë me Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a.) për shitblerjen e energjisë elektrike nga prodhimi i Hec-eve, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. ka bërë me dije se nuk ka nënshkruar ende një kontratë shit-blerje me këtë operator. Në lidhje me pikën e lidhjes/“Marrëveshjes për lidhje të re”, nuk ka dhënë një informacion. Por nga ana tjetër, në kuadër të licencimit shoqëria ka të vlefshme/të miratuar pikën e lidhjes me fuqinë me kapacitet total të instaluar 7320 kw.

- Njësitë e gjenerimit të HEC, sipas projektit të ndryshuar, do të jenë 3 (tre).

- Duke qenë se nga ana e shoqërisë u plotësua kushti i vendosur në vendimin e licencimit nr. 41/2020, i cili kishte të bënte me depozitim të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor, dhe më datë



6.4.2021, Bordi i ERE-s vendosi mbi disa ndryshime në vendimin nr. 41/2020, atëherë vendimmarrja finale për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nuk duhet të përmbajë kushtet e vendosura në vendimin nr. 41/2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 28 vjet e 5 muaj, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 3889 rep., nr. 959 kol, datë 27.7.2020, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim – operim – transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’ dhe ‘Backa C’”, si më poshtë:

Ishte:

“HEC ‘Backa 1’ me kapacitet të instaluar 1600 kw, HEC ‘Backa 2’ me kapacitet të instaluar 4000 kw, HEC ‘Backa A’ me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC ‘Backa B’ me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC ‘Backa C’ me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw.”.

Bëhet:

“HEC ‘Backa 1’ me kapacitet të instaluar 3366 kw, HEC ‘Backa A’ me kapacitet të instaluar 1347 kw, HEC ‘Backa C’ me kapacitet të instaluar 1910 kw, me kapacitet total 6623 kw.”.

2. Të shfuqizojë kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit nr. 69, datë 12.3.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, “Për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC ‘Backa 1’ me kapacitet të instaluar 1600 kw, HEC ‘Backa 2’ me kapacitet të instaluar 4000 kw, HEC ‘Backa A’ me kapacitet të instaluar 500 kw, HEC ‘Backa B’ me kapacitet të instaluar 500

kw, HEC ‘Backa C’ me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total të instaluar 7320 kw”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NJOFTIM
Nr. 4850, datë 21.4.2021

MBI HYRJEN NË FUQI

Protokolli i vitit 1997, “Për të ndryshuar Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet (MARPOL), 1973, siç është ndryshuar nga protokollin e vitit 1978”, aderuar me ligjin nr. 9/2020, ka hyrë në fuqi në datën 19 shkurt 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË

Shtetasi Arben Vila, lindur dhe banues në Shkodër, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër shpalljen e vdekjes së babait të tij, shtetasit Mhill Vila.

KËRKUES
Arben Vila

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë